



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 152/ Prot
9

Datë 08/02/2023

V E N D I M

Nr. 3

Datë 08/02/2023

**MBI MIRATIMIN E KALENDARIT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMEËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024
PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr. 23 dt. 22.11.2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI:

1. Të miratojë Kalendarin për procesin e hartimit të Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar dhe Buxhetit vjetor 2024 për Këshillin e Qarkut.
2. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Ekipi për Menaxhimin e Programeve dhe Administrata e Këshillit të Qarkut për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KRYETAR
Donald MOLISHTI



Ky vendim u miratua me vota pro : 10

Këshilltarë gjithsej : 18

Marrin pjesë në votim: 10

FaZA II	Hapi I	Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm, duke u bazuar edhe mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të miratuar.	Këshilli i Qarkut	Deri 30 Qershor 2023
			Kryetari	1-5 Korrik 2023
		Përgatitja e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi dhe hartimi i projekt vendimit për miratimin nga Këshilli i Qarkut me relacionin përkatës.	Kryetari	10 - 15 Korrik 2023
	Hapi II	Këshilli miraton tavanet përfundimtare		Deri në 20 Korrik 2023
		Kryetari i NJQV harton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit dhe e shpërndan tek sektorët me: a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; b) afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Kryetari	20-25 Korrik 2023
		Rishikimi i dokumentit të parë të Programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe përgatitja e materialit për miratim në Këshill.	EMP/GMS/Kryetari	1-10 shtator 2023
		Miratimi i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të rishikuar	Këshilli i Qarkut	Deri 15 Shtator 2023
		Dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të rishikuar dhe të miratuar nga këshilli i qarkut, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MFE gjatë fazës së parë.	Kryetari	Deri 15 Shtator 2023
		Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Deri 20 Tetor 2023
	Hapi III	Hartimi i projektbuxhetit vjetor me tabelat përkatëse dhe relacionet për miratim në Këshill.	Sektorët/GMS/Sektori i Financës	Deri në 30 Nëntor 2023
		Pas marrjes së mendimeve përfundimtare dhe bashkërendimit me Projekt buxhetor vjetor, paraqitet për miratim në këshill Dokumenti përfundimtar i PBA 2024-2026 Propozojnë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari.	Kryetari	Deri në 30 Nëntor
		Dokumenti përfundimtar i programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti i vitit të ardhshëm kalojnë për miratim në Këshillin e Qarkut.	Këshilli i Qarkut	Deri 10 Dhjetor 2023
		Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues	Kryetari	Deri 31 Dhjetor 2023
		Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave	Kryetari	Jo më vonë se 5 ditë nga Konfirmimi i tij
		Publikimi i buxhetit vjetor me informacionin përkatës	Kryetari	Jo më vonë se 15 ditë nga miratimi në Këshill


KRYETAR
 Donald MOLISHTI